



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1033/7

Tiranë, më 24/12 /2014

V E N D I M

Nr. 04 ,datë 24/12 2014

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" të procesverbalit të inspektimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale*" (Aluizni), Tiranë.

VËREJ SE :

Në zbatim të urdhrin nr. 169, datë 24.10.2014 është ushtruar inspektim administrativ pranë subjektit juridik publik "*Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale*" (Aluizni). Inspektimi administrativ ka filluar kryesisht nga Zyra e Komisionerit dhe ka patur si objekt: "*Verifikimi i zbatimit të Rekomandimit të Komisionerit Nr. 53 datë 30/05/2014 dhënë ndaj kontrolluesit Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (Aluizni) Tiranë*".

Kontrolluesi Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale nëpërmjet Rekomandimit nr. 53 datë 30/05/2014 detyrohet që në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", të ndryshuar, në faqen zyrtare në internet www.aluizni.gov.al të publikojë në një rubrikë të veçantë "*politikat e privatësisë*", me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshijë kushtet, kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale.

Nga inspektimi administrativ rezultoi se kontrolluesi Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, nuk e ka plotësuar detyrimin që mbart Rekomandimi nr. 53 datë 30/05/2014. Ky fakt provohet nga pohimet e përfaqësuesit të kontrolluesit dhe investigimi i bërë mbi faqen zyrtare në internet të kontrolluesit www.aluizni.gov.al.

Githashtu, në zbatim të nenit 32/1 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar kontrolluesi mbart detyrimin për të njoftuar me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për përmbushjen e detyrimeve të lëna në Rekomandim, duke paraqitur edhe provat përkatëse. Nga inspektimi administrativ u konstatua se një gjë e tillë nuk është realizuar.

Në zbatim të procedurave administrative, u mbajt procesverbali i inspektimit administrativ në të cilin u evidentua konstatimi i mësipërm si dhe u administruan provat e nevojshme. Një kopje e procesverbalit iu dorëzua kontrolluesit.

Përfaqësuesi i kontrolluesit pretendoi dhe pasqyroi në procesverbalin e inspektimit administrativ se, kopja e Rekomandimit nr. 53 datë 30/05/2014, nuk iu ka mbërritur zyrtarisht dhe nuk e disponojnë atë.

Ky pretendim i kontrolluesit nuk qëndron pasi nga investigimi i bërë dhe komunikimi me Postën Shqiptare rezulton se Komisioneri e ka përcjellë Rekomandimit nr. 53 datë 30/05/2014, nëpërmjet Postës Shqiptare, e cila në datën 4/06/2014 e ka dorëzuar pranë kontrolluesit.

Në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, më datë 03.12.2014 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit me autorizim të kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të inspektimit administrativ. Në këtë seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesi i kontrolluesit dhe u administruan pretendimet me shkrim.

Përfaqësuesi i kontrolluesit “Aluizni”, parashtrroi në këtë seancë se në kuadër të zbatimit të detyrave të lëna për zbatim nëpërmjet Rekomandimit nr. 53 datë 30/05/2014 janë marrë masat sa më poshtë:

“Është krijuar një seksion i posaçëm në faqen e internetit të ALUIZN-it, www.aluizni.gov.al, për “Politikat e Mbrojtjes së Sigurisë”. U aprovua dhe u publikua procedura e hyrjes në zonat me akses të kufizuar si dhe formularët përkatës që i bashkëlidhen kësaj procedure. Po punohet për të përgatitur një set procedurash bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe në rekomandimet e standardit ISO 27001 për të përsosur infrastrukturën, për mbrojtjen e sigurisë dhe informacionit”.

Komisioneri vlerëson se mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të internetit duhet të kryhet sipas parimit të respektimit dhe garantimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private. Publikimi i rubrikës “politikat e privatësisë”, ka si qëllim informimin e individëve, subjekte të të dhënave personale që aplikojnë online ose personave që vizitojnë këtë faqe, mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, si dhe masat e marra për sigurinë e të dhënave personale. Në këtë rubrikë duhet të publikohen të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. “Politikat e privatësisë” synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Autoriteti i Komisionerit vlerëson rëndësinë e respektimit të parimit të transparencës në përpunimin e informacionit të subjekteve të të dhënave në mënyrë që këta të fundit të kenë dijeni mbi: personat që njihen me të dhënat e tyre, qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave, kujt do t’i përhapen të dhënat, mbrojtjen e privatësisë. Për këtë arsye çdo individ/subjekt i të dhënave personale ka të drejtën e mbrojtjes së duhur të të dhënave të tij personale. Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet për aq sa është i nevojshëm, i drejtë, i ligjshëm dhe proporcional.

Komisioneri e vlerëson reagimin e kontrolluesit edhe pse ky reagim ka ardhur pas realizimit të inspektimit administrativ.

Në kuadër të zbatimit rigoroz dhe të plotë të dispozitave ligjore, Komisioneri vlerëson se moszbatimi në kohë i Rekomandimit nr. 53, datë 30.05.2014, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008

“Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 300.000 lekë. Gjithashtu në pikën 2 të nenit 39 është parashikuar se: “Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni”.

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes së kontrolluesit me detyrimet që rrjedhin për zbatimin e Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, mospërbushjen në kohë të detyrimit që mbart Rekomandimi i Komisionerit dhe masat reaguese të kontrolluesit për zbatimin e Rekomandimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 29, 30/2, 32, 39/1/b, 39/2, 40 dhe 41 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit “Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (Aluizni) Tiranë”, me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyre të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

